



Bundesamt
für Migration
und Flüchtlinge

Kthimi dhe riintegrim në Kosovë

Këshillim, mbështetje dhe
përkujdesje psikologjike

ALBANISCH



Rückkehr

Durchgeführt von:

giz

Deutsche Gesellschaft
für Internationale
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

BAMF





Kthimi si shans

Me projektin e riintegrit "URA", Enti Federal për Migracion dhe Refugjatë nxit kthimin e qëndrueshëm dhe social në Kosovë. Projekti mbështet njerëz, të cilët kthehen në Kosovë dhe iu tregon atyre mundësitë e një fillimi të ri. "URA" iu ofron të kthyerve perspektiva të reja dhe ndihmon gjatë riintegrit të qëndrueshëm në vendin e tyre të prejardhjes.

Qendra e kthimit në Prishtinë

Ne kuadër të konsultës këshilluese konfidenciale, do të identifikohen se bashku me të kthyerit nevojat individuale dhe zgjidhjet për ri-integrimin e tyre në Kosovë. Këshillimi social, ndërmjetësimi në punë dhe, nëse është e nevojshme, përkujdesja psikologjike të cilat iu japin njerëzve një perspektivë të re në vendin e tyre të origjinës dhe ua lehtësojnë atyre ri-përfshirjen.



Këshilltaret dhe këshilltarët regjistrojnë gjatë bisedës së parë të këshillimit të dhënat bazë të të kthyerve. Ata vlerësojnë objektivisht situatat përkatëse të të kthyerve dhe nevojat e tyre të veçanta për mbështetje.

Më tej ata hartojnë së bashku me ta një zgjidhje individuale për një perspektivë të qëndrueshme. Për këtë ata ndërmjetësojnë kontaktin për në vende të tjera të rëndësishme, shoqërojnë të kthyerit tek autoritetet si dhe në qendrat e Agjencive të punësimit në Kosovë dhe mbështesin në kërkim të vendbanimit.

Po ashtu ata informojnë mbi mundësitë të mëtejshme të mbështetjes, për shembull, të programit të Kosovës për integrim.

Informata dhe kontakti

Orari për konsulta në Qendrën e kthimit në Prishtinë janë nga e Hëna deri të Premten nga ora 9.00–11.30 dhe nga ora 12.30–16.00

Qendra e kthimit "URA – Die Brücke"

Ruga Arkitekt Karl Gega Nr. 38

10000 Prishtinë (Republika e Kosovës)

Telefon: +383 (0) 45 625 886

E-Mail: kosovo@bamf.bund.de

Njoftimi për ndihmë dhe mbështetje pranohet vetëm në Qendrën e kthimit në Prishtinë. Lajmërimi duhet të bëhet brenda tetë (8) javësh pas kthimit, tek Qendra e kthimit në Prishtinë.

Mbështetje financiare marrin vetëm të kthyerit nga:



Baden-
Vyrtembergu



Berlini



Bremeni



Saksonia e
Poshtme



Nordrain-Vestfalia



Saksonia



Saksonia-
Anhalt



Shlesvig-
Holstaini



Tyringeni

Mbështetja e mundshme

Mbështetja e menjëhershme mund të përfshijë sipas nevojës:

- këshillim social dhe ndërmjetësim pune falas
- rimbursim i pjesshëm të kostove të udhëtimit për në qendër
- mundësi pagese të njëhershme për tejkalim të situatës
- rimbursim i njëhershëm për trajtim dhe shpenzime mjekësore
- mundësi subvencionimi mujor i qirasë

Tek ofertat e ri-integrimit mund të numërohen:

- mbulim i njëhershëm i kostove për kurset e gjuhës
- ofrimi paisjeve bazë shkollore (materiale)
- oferta e mësimi plotësues për fëmijët e moshës shkollore dhe adoleshente
- subvencionim për kostot e trajnimit për zhvillim profesional teorik ose praktik
- subvencionim për shpenzimet e jetesës gjatë trajnimit profesional
- ndërmjetësim pune/ndërmjetësim i masave për krijimin e punës

Ne mbështetje te fillimit te themelimit te biznesit, mund të jepet një herë dhe vetëm në rastin e kthimit vullnetar:

- mbulimi i kostove të trajnimit profesional
- grant për trajnim
- të holla fillestare për ide biznesi që premtojnë sukses

Oferta, të cilat kalojnë përtej një këshillimi social, do të vendosen individualisht sipas nevojës respektivisht nevojave të veçanta. Një pretendim ligjor për ofertën mbështetëse nuk ekziston.

Shoqëria Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH) shpk mbështet projektin "URA" në Kosovë në emër të Entit Federal për Migracion dhe Refugjatë. GIZ-i e ka përsipër administrimin dhe ekzekutimin e projektit.

Projekti "URA" është me afat njëvjeçar dhe përfundon me vitin kalendarik. Pas kalimit të afatit projekti mund të zgjatet për një vit të mëtejshëm.

Informacione të mëtejshme:

www.bamf.de/return

www.bamf.de/ura

Botimi

Botoi:

Bundesamt für Migration und Flüchtlinge (BAMF)

Frankenstraße 210

90461 Nürnberg

info@bamf.bund.de

www.bamf.de

Tel.: +49 911-943-0

Fax: +49 911-943-1000

Gjendja: 07/2023

Shtyp: Bundesamt für Migration und Flüchtlinge, Nürnberg

Faqosja: KonzeptQuartier® GmbH, Fürth

Dëshmia e fotografive / ilustrimeve: iStock: BrianAJackson, BrilliantEye, Choreograph

Ju gjithashtu këtë publikim mund ta shkarkoni në formatin PDF-Dokument nën ueb faqen www.bamf.de/publikationen



Na vizitoni ne në

www.facebook.com/bamf.socialmedia

[@BAMF_Dialog](https://twitter.com/BAMF_Dialog)

Other Language 

www.bamf.de/publikationen

www.bamf.de